




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 07.12.2021, nxjerr këtë:



**V E N D I M**

- I. **Z.Branko Radovanovic**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, nga subjekti politik "SRPSKA LISTA", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Aleksandar Spiric.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Branko Radovanovic dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

**Arsyetim**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 06.12.2021, Nr.3282/2021, për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit Komunal z.Aleksandar Spiric, me rastin e dorëheqjes së tij, për arsye të obligimeve private.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës është z.Branko Radovanovic.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I, të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.12.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

